

## **Formësojmë “Normalin e ri” - Roli i Arsimit dhe Mësimnxënies te të Rriturit në përballimin e pandemisë Korona**

Shoqëritë anembanë globit janë goditur rëndë nga virusi Korona (COVID-19). Njerëzit po preken në jetën e tyre të përditshme dhe po brengosen për pasojat ndaj shëndetit, punës dhe mirëqenies së tyre. Ndër ata që goditen më rëndë janë miliona njerëz të varfër që i humbin të ardhurat, gratë që preken nga dhuna në bazë gjinore dhe migrantët që vuajnë nga ksenofobia në rritje. Në pothuajse të gjitha shtetet e botës, ofruesit e arsimit për të rinj dhe të rritur janë detyruar që përkohësisht t'i mbyllin dyert, me pasoja dramatike për qëndrueshmërinë e këtyre institucioneve, punonjësit si dhe nxënësit. Në të njëjtën kohë, arsimit dhe mësimnxënia te të rriturit (AMRr) mund të kontribuojnë në lehtësimin e pasojave të krizës, në ofrimin e arsimit dhe aftësimin të shumë-nevojshëm dhe në përkrahjen e veprimeve sociale në formësimin e “normalitetit të ri”.

DVV International, si partneri i vetëm i zhvillimit që fokusohet në AMRr, sugjeron koncepte se si AMRr mund të kontribuojë në menaxhimin e krizës duke ofruar shërbime sociale dhe arsimore, veçanërisht për grupet e cenueshme. Në të njëjtën kohë, ne i nxisim qeveritë dhe aktorët ndërkombëtarë që t'u sigurojnë ofruesve të AMRr - organizata publike, private dhe të shoqërisë civile - dhe stafit të tyre resurset e nevojshme për t'u përballur me këtë situatë dhe për ta siguruar një të ardhme të qëndrueshme për sektorin AMRr.

### **Përdorimi i potencialit të AMRr për ta luftuar krizën**

AMRr është nën-sektor i sistemit arsimor me një ndërthurje të karakteristikave të cilat kanë vlerë të veçantë në situatën e tanishme. Ofrimi i AMRr drejtohet vetëm nga kërkesa, është fleksibil, kryesisht joformal dhe orientohet drejt veprimit. Bazuar në këtë, ofruesit dhe projektet AMRr e kanë potencialin për t'i përkrahur njerëzit në shumë mënyra duke ofruar p.sh. përkrahje për prindërit në aranzhimin e shkollimit nga shtëpia ose duke i luftuar lajmet e rreme për natyrën e virusit duke ofruar arsim të besueshëm shëndetësor për të gjitha segmentet e popullatës.

### **Të zhvillohen ofertat e reja**

Në tërë botën, aktivitetet e mësimin ballë-për-ballë po kufizohen ose pothuajse kanë ndaluar plotësisht. Si rrjedhojë, shumë pjesëmarrësve u mungon mundësia për të marrë pjesë në mundësitë esenciale të mësimnxënies. Në këtë situatë, zhvillimi i shpejtë i mundësive për mësimnxënie virtuale luan rol kyç. Kjo kërkon investime në qasjen digjitale, ndërtimin e kapaciteteve, posaçërisht për mësimdhënësit, dhe zhvillimin e programeve dhe qasjeve të reja AMRr.

### **Të sigurohet e ardhmja e qëndrueshme e AMRr**

Për shumicën e ofruesve të AMRr, nëse jo të gjithë, kjo është krizë ekzistenciale. Me zvogëlimin e mundësive për të ardhura (p.sh. tarifatat e pjesëmarrësve, të paktën ndërprerja e

Education for Everyone. Worldwide.  
Lifelong.

përkohshme e fondeve të projektit), ofruesit e AMRr dhe një numër shumë i lartë i stafit mësimdhënës të pavarur po përballen me sfida ekzistenciale ekonomike. Është roli i publikut dhe i qeverive në tërë botën që ta sigurojnë mbijetesën e sektorit AMRr.

Ashtu si në sektorët tjerë të sistemit arsimor, nevojitet përkrahja e drejtpërdrejtë financiare!

### **Sigurooni hapësira dhe mundësi për ta punuar “botën që e duam”**

Pandemia i ka vënë në qendër të vëmendjes disa sfida me të cilat përballen shoqëritë tona: mungesa e reziliencës në shumë komunitete, ndikimi i përçarjeve sociale, kërcënimet e ndryshimeve klimatike, risqet e globalizmit - janë disa prej tyre. AMRr mund të sigurojë hapësirë për të rinjtë dhe të rriturit që të mendojnë për zgjidhjet dhe të pajisen për t'i kontribuar transformimit pozitiv.

Qeveritë, partnerët e zhvillimit dhe agjencitë ndërkombëtare mund të bëjnë shumë në përkrahje të AMRr:

- Bashkohuni me partnerët dhe rrjetet në përpjekjet e tyre për të avokuar rreth kuptimit të arsimit si një dobi publike. AMRr duhet të njihet dhe të financohet si pjesë integrale e sistemit arsimor.
- Të përkrahen ofruesit e AMRr në përpjekjet e tyre për të zhvilluar mundësi të reja digjitale të orientuara nga kërkesa dhe të sigurohet se të gjithë nxënësit kanë mundësinë për t'i përdorur ato.  
Qasja digjitale për të gjithë duhet të bëhet një dobi publike siç është uji ose energjia elektrike.
- Të sigurohen skema fleksibile e të përshtatura të fondeve për mbrojtjen e substancës institucionale dhe stafit kyç të ofruesve dhe rrjeteve esenciale të AMRr.

'DVV International' e sheh rolin e vet si përkrahës i partnerëve të saj në përballimin e krizës së Koronës në mënyrën më të mirë të mundshme dhe zhvillues i formateve për shërbime esenciale AMRr si përgjigje ndaj kësaj krize. Instituti do të vazhdojë të jetë i pranishëm në më shumë se 30 shtete dhe do ta përdorë ekspertizën e vet në adaptimin e strukturave dhe të shërbimeve të AMRr në përputhje me kërkesat e reja. Koronavirusi është krizë globale, dhe duhet të sigurojmë se përgjigja ndaj tij është vërtetë globale dhe e synuar drejt një “normaliteti të ri, të qëndrueshëm”, ku AMRr njihet në të gjitha dimensionet e veta.

*Korrik 2020*